



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 167, Datë 22.10.2020

MBI

ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “KOKA&ERGI ENERGJI STAVEC” SH.P.K. PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nën 14 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 114/3 Prot, datë 19.10.2020, të Drejtorisë së Licensimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi shtyrjen me 30 dite pune të afatit të vendimmarrjes finale të bordit të ERE-s, të shoqërisë “Koka&Ergi Energji Stavec” sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Me vendimin Nr. 143, datë 28.08.2020, ka filluar procedura për licensimin e shoqërisë “Koka&Ergi Energji Stavec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/26, datë 28.08.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Koka&Ergi Energji Stavec” sh.p.k..
- U konstatua se njoftimi drejtuar shoqërisë “Koka&Ergi Energji Stavec” sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të mbetur, nuk ishte dërguar në afat.
- Ndodhur në kushtet kur shoqëria nuk ka marrë në kohë mbi njoftimin e ERE-s, u vijua me dërgimin në rrugë zyrtare elektronike në datën 15.10.2020 të këtij njoftimi.
- Me qëllim dhënien e kohës së arsyeshme për aplikuesin për plotësimin e dokumentacionit të munguar, brenda afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, lind nevoja e zgjatjes së afatit procedural për shqyrtimin e këtij aplikimi.
- Bazuar në nenin 14 pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar,

parashikohet se : “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune”.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Koka&Ergi Energji Stavec” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në datë 09.11.2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI